

GJON BORIÇI

PROBLEMATIKA SHQIPTARO-KINEZE NË INFORMACIONET E DIPLOMATËVE SHQIPTARË (1971-1977)

Krisja e marrëdhënieve shqiptaro-kineze në vitin 1971

Marrëdhëniet shqiptaro-kineze në vitet '70 fituan një specifikë të veçantë. Duke qenë se ishte i vetmi vend aleat që i kishte mbetur Shqipërisë, marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve në sytë e publikut dukeshin mjaft të mira. Megjithatë, nga hulumtimi i kujdesshëm i arkivave në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe në Arkivin Qendror të Shtetit në Tiranë, relacionet e shumta që kanë dërguar diplomatët shqiptarë jo vetëm në Kinë, por edhe nga vende të tjera ku shërbenin në Evropë dhe në botë, gjërat nuk ishin aq të thjeshta. Udhëheqja komuniste shqiptare tjetër panoramë i paraqiste publikut shqiptar ndërkohë që diplomatëve të saj, kur ishte fjala për marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve, u jepte udhëzime të ndryshme.

Situata ndërkombëtare në fillimin e viteve '70 të shek. XX pësoi ndryshime. Shtetet e Bashkuara të Amerikës nëpërmjet strategjisë së politikës trekëndore të iniciuar nga presidenti Riçard Nikson (Richard Nixon) synonte afrimin me Republikën Popullore të Kinës.¹ Vizita sekrete e asistentit për Sigurinë Kombëtare të presidentit Nikson, Henri Kissinger (Henry Kissinger) në datat 9 dhe 11 korrik 1971 në Pekin² i cili pas takimit me kryeministrin Çu En Lai, shtroi rrugën për vizitën zyrtare të presidentit amerikan në Republikën Popullore të Kinës. Këtu, fillon e merr jetë përplasja e parë e madhe ndërmjet udhëheqjes politike shqiptare dhe asaj kineze.

Pas largimit të Kissingerit nga Kina dhe pas bërjes publike të vizitës së tij në shtypin botëror, më datë 17 korrik 1971, kryeministri kinez Çu En Lai, thërret në takim ambasadorin e Republikës Popullore të

¹ Henry Kissinger, *White House Years*, London: Phoenix press, 2000, f. 724.

² *Po aty*, f. 739.

Shqipërisë, Xhorxhi Robo, për ta informuar lidhur me vizitën e këshilltarit të Sigurisë Kombëtare të SHBA-së.³

Kryeministri kinez, i bën një ekspozitë të plotë ambasadorit Robo lidhur me vizitën e Kisingerit në Kinë. Sipas relacionit që dërgoi Xhorxhi Robo në Tiranë, Çu En Lai i kishte shpjeguar se pas 16 vjet bisedimesh me amerikanët në rang ambasadorësh kishte ardhur koha që presidenti Nikson të vinte në Kinë e të takohet me kryetarin Mao.⁴ Sipas asaj që njoftonte ambasadori Robo, bisedimet 16 vjeçare ndërmjet amerikanëve dhe kinezëve kishin prekur këto probleme themelore:

1. Tajvanin;
2. Bashkekzistencën paqësore.⁵

Raporti që ambasadori Robo i dërgoi Tiranës ishte përshkruar deri në detajet më të imta lidhur me takimin që kishte zhvilluar me kryeministrin kinez. Njëlloj si tek kolegët e tjerë ambasadorë të Republikës Popullore të Shqipërisë të akredituar nëpër botë, raportet ishin thjesht përshkruar dhe nuk jepnin asnjë mendim apo prognozë që udhëheqja shqiptare duhet ta merrte parasysh. Në këtë takim, kryeministri kinez u tregua i ndershëm në bisedën e zhvilluar me ambasadorin shqiptar. Duke bërë një krahasim ndërmjet asaj çfarë ka shkruar në librin e tij, Henri Kisinger dhe studiues të tjerë lidhur me vizitën e tij sekrete në Kinë dhe asaj çfarë ka referuar ambasadori shqiptar, përputhshmëria është pothuajse e plotë.⁶ Studiues të

³ Arkivi *Qendror i Shtetit* [më tej: *AQSH*], Fondi [më tej: F.] 14, Arkivi i Partisë-Marrëdhëniet me Partinë Komuniste të Kinës [më tej: AP-MPKK], Viti [më tej: V.], 1971, Dosja [më tej: D], 3, fl. 1. Biseda e shokut Çu En Lai në Pekin me shokun Xhorxhi Robo, më 17 korrik 1971.

⁴ *Po aty*. Nga raporti i ambasadorit Xhorxhi Robo gjatë takimit me Çu En Lai-n: “Bisedimet me amerikanët i kemi vazhduar për 16 vjet rrjesht, më parë në Gjenevë dhe pastaj në Varshavë, por pa rezultat. Prandaj mund të themi se bisedimet me Niksonin janë rezultat i shkallëzimit të bisedimeve në rang ambasadorëve venë në një shkallë më të lartë, vjen vetë Niksoni në Kinë dhe do të bisedojë me kryetarin Mao. Niksoni tha se do të vijë në Pekin dhe do të bisedojë me kryetarin Mao. Mos nuk është një shkallëzim i bisedimeve. Po të më pyesin mua unë këtë përgjigje do t’u jap. Niksoni ka kërkuar që të vijë dhe bisedojë. Ai vetë ka thënë se për 3 vjet me radhë ka patur dëshirë që të vijë në Kinë për bisedime. Dhe me njoftimin zyrtar shprehet kjo dëshirë e tij. Ai nuk do të vijë si turist, por do të vijë për bisedime. Është e vërtetë që ai gjatë këtyre 3 viteve ka bërë shumë për këtë ardhje”.

⁵ *Po aty*, fl. 3.

⁶ *Po aty*, fl. 8-18. “Ardhja e Kisingerit kishte dy qëllime: 1. Përgatitjen e vizitës së Niksonit. 2. Bisedime paraprake për të filluar bisedimet e nivelit të lartë. Kisingeri e filloi bisedën me atë që tha Niksoni që gara ushtarake të kalojë në garë ekonomike. I

ndryshëm me eksperiencë e njohuri solide në marrëdhëniet ndërkombëtare kanë bërë analizat përkatëse dhe kanë dhënë prognozot (parashikimet) lidhur me statusin e Kinës në botë pas vizitës së Kisingerit fillimisht dhe të Niksonit gjashtë muaj më vonë. Diplomatët shqiptarë mbetën thjesht deskriptivë dhe aspak analitikë në njoftimet që i dërgonin Tiranës. Tagrin për të bërë prognozë dhe për të dhënë mendime edhe kur nuk i takonte, e kishte vetëm udhëheqësi komunist shqiptar Enver Hoxha, askush tjetër. Pasi u njoh me materialin 47 faqesh që ambasadori Xhorxhi Robo dërgoi nga Pekini, Hoxha mori guximin t'i dërgojë Mao Ce Dunit një letër të gjatë prej 19 faqesh ku bënte "analizat" e tij dhe mbi të gjitha prognozot se përse Kina nuk duhej ta priste Niksonin në Pekin dhe sesa dëm do t'i shkaktonte kjo vizitë marksizëm-leninizmit botëror.⁷ Letra e Enver Hoxhës ishte një detyrim për t'u lexuar dhe kuptuar nga i gjithë

thamë se nuk marrim pjesë në këto gara sepse garat ekonomike do të sjellin patjetër garat ushtarake. Shembull. Ka më se 20 vjet që bëhen konferenca për çarmatimin, jo vetëm nuk janë pakësuar çarmatimet, por ato janë zgjeruar më shumë. Bisedimet me Kisingerin qenë korrekte dhe pa angazhim. Në bisedimet me Kisingerin ja bëra atij më të plotë dhe më të qartë.

- 1.- Marrëdhëniet midis Kinës dhe Amerikës do të normalizohen kur të njihen RP e Kinës si e vetmja qeveri e ligjshme.
- 2.- Taivani është provincë e Kinës, pjesë e pandarë e territorit të saj. Çlirimi i Taivanit është punë e brendshme e Kinës dhe nuk lejohet që të ndërhyhet nga jashtë.
- 3.- Problemi "Dy Kina" "Një Kinë dhe një Taivan" është absurditet dhe nuk pranohet nga ne.
- 4.-Teoria e papërcaktueshmërisë së Taivanit është fjalë boshe. Deklarata e Kairos dhe e Potsdamit thonë që Kina e ka marrë Taivanin.
- 5.- Do të luftojmë kundër lëvizjes për pavarësi të Taivanit. Kjo lëvizje është një tradhëti dhe përkrahet nga SHBA e Japonia.
- 6.-Trupat ushtarake amerikane të tërhiqen nga Taivani dhe të ç'montohen të gjitha bazat ushtarake.
- 7.- Nuk e njohim traktatin midis Amerikës dhe Çan Kai Shisë, ai të shtuqizohet. (nga 7 pikat, për 5 pikat e para Çan Kai Shia është dakord). Ndryshe nga Gjermania-Koreja-Vietnami që kërkohet përjashtimi i ndarjes. Në dy pikat e fundit do që trupat amerikane të qëndrojnë dhe traktati të jetë në fuqi.
- 8.- Të rivendosen të drejtat e Kinës në OKB. Këtë Çan Kai Shia e ka të kundërt me ne".

Shih edhe H. Kissinger, *White House Years ...*, f. 739-760; Henry Kissinger, *On China*, London: Allen Lane, 2011, f. 241-267; Henry Kissinger, *World Order; Reflections on the character of the nations and the course of history*, London: Allen Lane, 2014, f. 302-308; Margaret Macmillan, *Nixon and Mao; the week that changed the world*, New York: Random House, 2007, f. 185-208.

⁷ *AQSH*, F. 14 / AP-MPKK, V. 1971, D. 3, fl. 48-66.

aparati i Komitetit Qendror të PPSH-së, nga kuadrot kryesorë të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe ambasadorët e Shqipërisë.⁸ I gjithë aparati shtetëror i KQ të PPSH-së dhe përfaqësuesit diplomatikë të Shqipërisë duhet të “mësonin” nga analiza dhe prognoza që Enver Hoxha i bënte marrëdhënieve ndërkombëtare në letrën dërguar Mao Ce Dunit.

Letra e Enver Hoxhës sigurisht mbeti pa përgjigje nga ana e Kinës. Ftohja në marrëdhëniet shqiptaro-kineze kishte filluar. Më 14 tetor 1971, sekretari i Komitetit Qendror të PPSH, Ramiz Alia, njoftohet nga ambasadori kinez në Tiranë se Komiteti Qendror i Kinës nuk do të dërgonte një delegacion në Kongresin VI të PPSH-së.⁹ Plasaritjet në marrëdhëniet e Shqipërisë me Kinën nuk u mbyllën edhe pas rezolutës së famshme shqiptare në OKB të 25 tetorit 1971, kur Kina u pranua me të drejta të plota dhe u përjashtua nga organizata Tajvani.¹⁰

Shqipëria nuk kishte vend tjetër ku të mbështetej për të ruajtur sistemin e saj diktatorial komunist nëse edhe me Kinën marrëdhëniet do të kishin të njëjtin fat si ato me Jugosllavinë më 1948 dhe me Bashkimin Sovjetik më 1961. Ndër objektivat kryesore që Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës Popullore të Shqipërisë kishte vendosur në marrëdhëniet me Kinën, dërguar të gjitha përfaqësive diplomatike shqiptare nëpër botë me aprovimin e Byrosë Politike dhe personalisht të Enver Hoxhës ishin:

- a. Mbështetje Kinës në arenën ndërkombëtare - Rivendosja e të drejtave të saj në OKB.
- b. Mbështetje në organizatat ndërkombëtare ku ajo [Kina] nuk bën pjesë.
- c. Të vazhdonte lufta parimore në drejtim të demaskimit të imperializmit amerikan, revizionizmit sovjetik si dhe kompleteve të tyre në drejtim të RP të Kinës.

⁸ *Po aty*, fl. 68.

⁹ *Po aty*, F. 14, AP-MPKK, V. 1971, D. 9, fl. 1. Nga takimi i ambasadorit kinez në Tiranë me Ramiz Alinë, më datë 14 tetor 1971: “Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Kineze mori ftesën e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë për të dërguar një delegacion në Kongresin VI të PPSH. Ftesa është një shprehje e miqësisë revolucionare që lidh dy partitë tona. Për këtë i shprehim falenderimet Partisë së Punës të Shqipërisë. Që nga Kongresi IX i Partisë Komuniste Kineze, Partia jonë caktoi si parim që në Kongreset e veta nuk do të ftojë asnjë parti motër, dhe Partia jonë nuk do të marrë pjesë në kongreset e partive motra”.

¹⁰ Sokrat Plaka, *Kujtime*, Tiranë: Marin Barleti, 2004, f. 33-34.

- d. Të ndiqej politika e jashtme e RP të Kinës, zgjerimi i marrëdhënieve të saj me jashtë dhe qëndrimet e saj për problemet ndërkombëtare. Në mënyrë të veçantë ta ndiqte këtë çështje ambasada shqiptare në Pekin.
- e. Të ndiqeshin me kujdes sukseset e RP të Kinës, gjendja e brendshme atje, zbatimi i konkluzioneve dhe detyrave të shtruara nga kongresi i IX i PKK.¹¹

Edhe në takimin që ministri i Jashtëm i Republikës Popullore të Shqipërisë, Nesti Nase, pati me ambasadorin kinez në Tiranë Liu Xhen Hua, i foli hapur se detyra kryesore e Shqipërisë në politikën e jashtme ishte forcimi i vazhdueshëm i miqësisë me popullin kinez dhe me Republikën Popullore të Kinës.¹² Shqipëria asokohe kishte marrëdhënie diplomatike me 48 vende në botë¹³, por asnjë prej tyre vendeve nuk kishte statusin e marrëdhënies së veçantë siç ishte ajo e Shqipërisë me Kinën. Interesant është fakti se në këtë takim, ambasadori kinez citon Mao Ce Dunin duke e quajtur Shqipërinë “fener të madh ndriçues të socializmit në Evropë”.¹⁴

Në një deshifrim tepër sekret nga Pekini të datës 8.7.1971, dërguar MPJ të Shqipërisë, thuhej se diplomatët francezë, suedezë dhe së fundi jugosllavë flisnin se ekzistonin mosmarrëveshje ndërmjet Kinës dhe Shqipërisë për faktin se shqiptarët nuk përkrahnin afrimin kinez me

¹¹ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme* [më tej: *AMPJ*], Viti [më tej: *V.*] 1971, Dosja [më tej: *D.*] 152, fl. 2. Disa objektiva dhe detyra në marrëdhëniet e vendit tonë me RP të Kinës për vitin 1971.

¹² *Po aty*, fl. 12.

¹³ *Po aty*, fl. 13. Nga fjala e Nesti Nases drejtuar ambasadorit kinez në Tiranë: “Në politikën tonë të jashtme ne përkrahim sipas mundësive tona lëvizjet revolucionare dhe N.Ç.L. të popujve të të gjithë botës, përkrahim luftën kundër imperializmit, revizionizmit dhe kolonializmit. Ne kemi marrëdhënie me 48 vende dhe po bisedojmë edhe me disa vende të tjera. Marrëdhëniet tona me vendet kapitaliste e revizioniste janë mbi bazën e 5 parimeve bashkëekzistuese paqësore, pa bërë asnjë lëshim nga ana ideologjike e politike. Ne gjithmonë kemi mbajtur dhe do mbajmë qëndrimin tonë të hapur për probleme të ndryshme ndërkombëtare, kemi demaskuar dhe do demaskojmë pa pushim planet djallëzore dhe politikën agresive dhe ekspansioniste të imperialistëve amerikanë dhe revizionistëve sovjetikë”.

¹⁴ *Po aty*. Fjala e ambasadorit kinez: “Kryetari Mao na mëson se Shqipëria është një fener i madh ndriçues i socializmit në Europë. Ne këtë e pamë mbrëmë që pa zbritur nga avioni, ku ndriçonin kudo dritat elektrike. Kjo është një fitore e madhe që do të ndihmojë shumë në forcimin e gjithë ekonomisë së vendit. Gazetat tona flasin çdo ditë mbi fitoret tuaja. Ato janë një frymëzim i madh për neve”.

vendet socialiste të Evropës Lindore dhe Bashkimit Sovjetik.¹⁵ Diplomatët shqiptarë nuk e kishin të lejuar të bënin analizë të këtyre informacioneve, por sapo i dëgjonin apo kur ia thonin kolegët nga vende të tjera, thjesht i “demaskonin” dhe i paraqisnin si intriga imperialisto-revizioniste.¹⁶

Letra e Enver Hoxhës dërguar Mao Ce Dunit mbi refuzimin e Shqipërisë për të qenë dakord me politikën e Kinës për t’u afruar me SHBA-të nëpërmjet vizitës së Niksonit, u dorëzua nga vetë ambasadori Xhorxhi Robo, kryeministrit Çu En Lai më 12.8.1971.¹⁷ Kryeministri kinez duke parë se letra ishte voluminoze kërkoi me mirësjellje që ambasadori Robo t’i thoshte vetëm përmbledhtazi gjërat kryesore të saj.¹⁸ Por, ambasadori shqiptar kishte marrë urdhër nga Tirana që letrën duhet ta lexonte të tërën dhe kryeministri kinez pati durimin të dëgjonte një letër të gjatë 19 faqe krejtësisht të pavlefshme për marrëdhëniet ndërkombëtare dhe pozitën e Kinës në botë. Duke qenë se nuk pati asnjë reagim nga Kina për letrën e Enver Hoxhës, më datë 10.10.1971, ministri i Jashtëm, Nesti Nase me anë të një shifrimi tepër sekret urdhëron ambasadorin Robo në Pekin që kur të kishte takime me udhëheqës kinezë, duhej vetëm të mos tregonte asnjë lloj interesi për vizitën e Kisingerit. Ai thjesht duhet të dëgjonte dhe të mos shfaqte asnjë mendim, të mos bënte asnjë pyetje dhe asnjë koment.¹⁹ Thjesht, ambasadori Robo, duhet të mbante çdo gjë shënim dhe t’i raportonte menjëherë udhëheqjes në Tiranë.

Në nëntor të atij viti nga Varshava, ambasada shqiptare njoftonte MPJ në Tiranë se përfaqësuesi i agjencisë detare të Gdanskut i kishte thënë një diplomati shqiptar atje se arsyeja e mosardhjes së një delegacioni kinez në Kongresin VI të PPSH mund të ishte vizita e

¹⁵ *Po aty*, fl. 42.

¹⁶ *Po aty*.

¹⁷ *Po aty*, fl. 58. Takimi i Xhorxhi Robos me Çu En Lain në Pekin mbi letrën dërguar në lidhje me mospritjen e Niksonit, 12 gusht 1971.

¹⁸ *Po aty*, fl. 59.

¹⁹ *Po aty*, fl. 105. “Shifrim Tepër urgjent 10.10.1971. Shokut Xhorxhi: Për vizitën e Kisingerit në Kinë mos tregoni asnjë interesim pranë shokëve kinezë. Në rast se shokët kinezë me inisiativën e tyre ju informojnë gjë për këtë vizitë, ju vetëm dëgjoni, por mos shfaqni asnjë mendim, mos bëni asnjë pyetje dhe asnjë koment. Vetëm thuaj se mbajte shënim dhe do t’ia transmetosh udhëheqjes dhe asnjë fjalë tjetër. Ministri”.

Niksonit në Kinë.²⁰ Gjithashtu, edhe disa studentë afrikanë kishin bërë të njëjtën pyetje dhe diplomati shqiptar ishte përgjigjur sipas porosive nga Tirana.

Raporte të diplomatëve shqiptarë për përkrahjen që Shqipëria i ka dhënë Kinës në organizata ndërkombëtare, 1973-1975

Rezoluta shqiptare e 25 tetorit 1971 për pranimin e Kinës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara [OKB] ishte e një rëndësie të madhe diplomatike. Përpjekja dhjetëvjeçare e Shqipërisë si zëri i Kinës në OKB u kurorëzua falë edhe një politike të kujdesshme e pragmatiste nga ana e Pekinit zyrtar në të cilin u gërshetuan interesa të mëdha gjeopolitike. Fatkeqësisht, ndihma që Shqipëria i dha Kinës në arenën ndërkombëtare nuk u shoqërua me një aksion të gjithanshëm politik, ekonomik dhe kulturor për të hapur vendin me pjesën tjetër të botës.

Në vitin 1973, vjen nga Vjena një deshifrim dërguar nga ambasada e Shqipërisë dërguar direkt Enver Hoxhës, Mehmet Shehut dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme, ku cilësohej falënderimi që delegacioni kinez kishte bërë në organizatën ndërkombëtare atomike për pranimin e Kinës në OKB.²¹

Një tjetër çështje e mprehtë që gjeti pasqyrim në raportet e diplomatëve shqiptarë ishte problemi i refugjatëve kinezë të cilët përbënin një nga dilemat e Kinës në marrëdhëniet me fuqitë perëndimore. Po në vitin 1973, raporti i Komisarariatit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për refugjatët bënte fjalë për ndihmën që u ishte dhënë refugjatëve nga

²⁰ *Po aty*, fl. 123. “Deshifrim nga Varshava tepër sekret 10.11.1971. Ministrisë së Jashtme. Përfaqësuesi i agjencisë detare në Gdansk i tha Vangjelit se shkak i mos ardhjes të delegacionit kinez në kongresin tuaj mund të jetë vizita e Niksonit në Pekin. Pyetën për këtë edhe disa studentë afrikanë. U përgjigjëm sipas porosisë tuaj”.

²¹ *AMPJ*, V. 1973, D. 136, fl. 2-3. Mbi përkrahjen që i ka dhënë vendi ynë Kinës në arenën ndërkombëtare. Shifrim nga Vjena, datë 28.02.1973. Fjala e ambasadorit kinez deklaruar ambasadorit shqiptar: “Ne kemi nevojë për eksperiencën diplomatike shqiptare në konferencat e organizatat multilaterale, midis tyre edhe në Inatom dhe Unido. Në MPJ më porositën t'i sjell përshëndetje ambasadës shqiptare në Vjenë e të falenderoj qeverinë shqiptare për përkrahjen e vendosur që i ka dhënë Kinës në agjencinë atomike për shumë vjet. Qëllimi i pjesëmarrjes së Kinës në Unido e në kryesinë e saj është të ndihmojë që ndihmat të shpërndahen me drejtësi. Ajo t'i jepet në radhë të parë vendeve që me të vërtetë kanë nevojë për zhvillimin industrial”.

Hong Kongu dhe Makao refugjatëve tibetianë dhe kinezë.²² Menjëherë Shqipëria nëpërmjet ambasadës së saj në OKB kishte shprehur keqardhjen për këtë raport dhe e kishte paraqitur atë si “ndërhyrje në punët e brendshme të Kinës”.²³ Shqipëria ishte në përkrahje të plotë të Kinës përse i përket çështjes së Tibetit dhe se ndihma që OKB i jepte këtyre refugjatëve ishte krejtësisht e paligjshme dhe e padobishme në konceptin e saj.²⁴ Shqipëria deklaronte dhe mbronte me të madhe në OKB dhe në çdo organizatë tjetër ndërkombëtare ku ishte e pranishme, se Tibeti ishte territor historikisht kinez dhe çdo lloj etiketimi tjetër ishte fryt i politikave ekspansioniste, kolonialiste, shkombëtarizuese të fuqive imperialiste dhe në rastin konkret të qeverisë indiane për të ndërhyrë në punët e brendshme të Kinës.²⁵

Po ashtu, kur flitej për Hong Kongun dhe Makaon, edhe pse ishin pjesë e juridiksioneve evropiane të Britanisë së Madhe dhe Portugalisë, Shqipëria nuk linte rast pa përmendur se ato ishin pjesë territoriale e pandashme e Kinës dhe se “refugjatët” sipas saj ishin thjesht lëvizje brendapërbrenda të njëjtit territor.²⁶ Një deklaratë e tillë padyshim që mund të shkaktonte një incident të rëndë diplomatik, por Britania e Madhe dhe Portugalia [Hong Kongu dhe Makao ishin nën juridiksionin e

²² *Po aty*, fl. 9.

²³ *Po aty*.

²⁴ *Po aty*. Mbi të ashtuqajturën çështje të “refugjatëve kinezë”.

²⁵ *Po aty*. Siç dihet, historikisht Tibeti ka qenë një territor kinez dhe krijimi i të ashtuqajturve çështje të “refugjatëve tibetianë” është rezultat i drejtpërdrejtë i politikës ekspansioniste dhe i ndërhyrjes brutale të qeverisë indiane në punët e brendshme të Kinës, e cila në vitin 1959 mashtroi dhe detyroi shumë tibetianë të arratiseshin në Indi, mbas dështimit të plotë të rebelimit të skllavopronarëve tibetianë, që kishte për qëllim ruajtjen e marrëdhënieve të urryera skllavopronare në këtë rajon dhe shkëputjen e Tibetit nga juridiksioni i Kinës.

²⁶ *Po aty*, fl. 10-11. Po kështu, krejt e paqenë është edhe çështja e të ashtuqajturve “refugjatë kinezë” të Hong Kongut dhe Makaos, e cila gjithmonë është trajtuar në mënyrë të paligjshme për vite me radhë nga organet e komisarit të lartë të Kombeve të Bashkuara për refugjatët. Siç është e njohur botërisht, Hong Kongu dhe Makao janë territore të Kinës dhe si pasojë është krejt e natyrshme që kinezët e atjeshëm të mbajnë lidhje të ngushta farefisnore dhe miqësore me popullin në rajonet e tjera të Kinës. Për këtë arsye, lëvizjet midis popullsisë kineze, brenda territoreve kineze që kanë ekzistuar tradicionalisht, janë të pashmangshme dhe krejt të natyrshme. Në këtë rat nuk kemi të bëjmë fare me një çështje refugjatësh, por me një shkëmbim të zakonshëm të njerëzve nga një rajon në tjetrin dhe anasjelltas, prandaj kjo gjë nuk duhet lejuar të shërbejë si pretekst ndërhyrjeje në punët e brendshme të Kinës, duke frymëzuar për këtë qëllim Kombet e Bashkuara.

tyre] u treguan të matura dhe nuk reagueshin ndaj deklaratës shqiptare në OKB.

Megjithë këtë propagandë të madhe e të pandërprerë në mbështetje të Kinës në organizatat ndërkombëtare, përsëri marrëdhëniet shqiptaro-kineze nuk po jepnin shenja rivitalizimi. Nga jo pak vende evropiane ku ishin akredituar ambasadorët shqiptarë, vërshuan me dhjetëra telegrame ku njoftohej Ministria e Jashtme e Shqipërisë për informacionet që ambasadorë të vendeve të tjera i raportonin vendeve të tyre lidhur me ftohjen e marrëdhënieve shqiptaro-kineze. Kështu, më 5 janar 1974, nga ambasada shqiptare në Pragë erdhi njoftimi se Finlanda kishte shfaqur interes për Shqipërinë tani që marrëdhëniet me Kinën nuk ishin më aq të mira.²⁷ Por, diplomatët shqiptarë vijonin t'i mohonin të gjitha këto fjalë duke theksuar me të madhe se marrëdhëniet shqiptaro-kineze ishin të forta dhe se çdo gjë tjetër ishte thjesht hipokrizi e demagogji. Shqipëria po përpiquej me çdo kusht e me çdo mjet që të dukej se ende Kina ishte mbështetësjja e vetme e Shqipërisë. Vështirësitë në marrëdhëniet shqiptaro-kineze sa vinin e rriteshin. Kjo vërtetohet nga një telegram shumë i rëndësishëm që erdhi nga ambasada shqiptare në Pekin më datë 6 mars 1974, ku njoftohej MPJ shqiptare se Lin Biao* në fundin e viteve '60 (para se të aksidentohej me avion) kishte akuzuar udhëheqjen e PPSH-së për ekstremizëm ndaj një anëtareje të Byrosë Politike, Liri Belishovës, për të cilën kishte thënë se ishte ekzekutuar.²⁸ Kjo deklaratë e

²⁷ *APMJ*, V. 1974, D. 98, fl. 3. Shifrim nga ambasada shqiptare në Pragë: "Sipas një të dhëne nga Stokholmi ambasadori i Finlandës, Loivola i ka raportuar qeverisë së tij se ka një ftohje në marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Kinës. Edhe kur ishte herën e fundit në Tiranë, finlandezi është interesuar për këto marrëdhënie. Atij iu bë e qartë se marrëdhëniet tona janë shumë të ngushta e vëllazërore dhe forcohen vazhdimisht. Prandaj në takimet me Loivolën i keni parasysh këto kur të jetë rasti. I flisni për marrëdhëniet tona shumë të mira Shqipërisë dhe Kinës dhe demaskoni demagogjinë e hipokrizinë e revizionistëve sovjetikë lidhur me përmirësimin e marrëdhënieve me vendin duke iu përmbajtur qëndrimit tonë të njohur. I jepni gjithashtu edhe materiale të ndryshme që kanë të bëjnë me qëndrimin tonë karshi Kinës siç ishin telegrami dhe veprimtari të tjera që u bënë në Shqipëri me rastin e 80 vjetorit të kryetarit Mao".

* *Lin Biao* (5.2.1907-13.9.1971) - mareshal i Republikës Popullore të Kinës; zëvendëskryetar i parë i Republikës Popullore të Kinës, 1966-1971; zëvendëskryetar i Partisë Komuniste të Kinës 1958-1971; zëvendëskryeministër i Republikës Popullore të Kinës, 1958-1971; ministër i Mbrojtjes Kombëtare i Republikës Popullore të Kinës 1959-1971.

²⁸ *Po aty*, fl. 51. Dëshifrim tepër sekret shokut Enver, shokut Mehmet, Ministrisë së Jashtme Tiranë, 6 mars 1974.

thënë nga Lin Biao nuk ishte e vërtetë pasi Liri Belishova nuk ishte pushkatuar, por internuar pas prishjes së marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik.

Nga ambasadat kineze të akredituara nëpër vende të ndryshme, nuk flitej keq për Shqipërinë, madje trumbetohej Enver Hoxha si miku më i madh e i afërt i popullit kinez.²⁹ Por, nuk ishin edhe të pakta rastet kur zyrtarë kinezë bëheshin sarkastikë lidhur me marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve. Në datën 24 tetor 1974, nga Pekini vjen një telegram tepër sekret ku theksohej se zëvendës drejtori i firmës “MashinoImpex” kishte theksuar në një darkë se Kina nuk i kishte kryer mirë të gjitha detyrat ndaj Shqipërisë dhe se ndihma që Shqipëria i kishte dhënë Kinës nuk mund të krahasohej me disa hidrocentrale e uzina që po ndërtoheshin me ndihmën e saj në Shqipëri.³⁰

Duke patur në dorë informacione të tilla, dhe tepër i bindur se marrëdhëniet e vendit të tij me Kinën nuk do ta kishin të gjatë, megjithatë Enver Hoxha, vazhdimisht instruktonte çdo delegacion shqiptar kur shkonte në Kinë që të flitej gjithnjë për miqësinë e përbashkët.³¹ Një përkrahje të madhe, Shqipëria i dha Kinës për anëtarësimin në Organizatën Botërore të Meteorologjisë³², pas anëtarësimit në Organizatën Olimpikë Botërore në Romë në maj të vitit 1975.³³ Shqipëria nëpërmjet zëvendësministrit të Punëve të Jashtme Reiz Malile, do të ishte inisiatore për vënien në rendin e ditës të Asamblesë së Përgjithshme të Komiteteve Kombëtare Olimpikë Botërore për anëtarësimin e Kinës në këtë organizatë.³⁴ Në mbledhjen e Komitetit Olimpik Botëror që u mbajt

²⁹ *Po aty*, fl. 104. Dëshifrim tepër sekret nga Bukureshti shokut Enver, shokut Mehmet, Ministrisë së Jashtme 12 korrik 1974. “Me rastin e 10 korrikut ambasadori kinez dhe atasheu ushtarak me ndihmësin e tij bëri një vizitë në përfaqësi ku u prit nga Koçoja. Në emër të ushtarakëve kinezë, të ambasadorit dhe gjithë kolektivit na transmetoi urime shumë të ngrohta. Ngriti shumë lart rolin e partisë, popullit dhe ushtrisë tonë si gjatë luftës edhe sot nën udhëheqjen e partisë dhe udhëheqësit të madh marksist-leninistit e mikut më të afërt të popullit kinez, shokut Enver Hoxha”.

³⁰ *Po aty*, fl. 186. Dëshifrim tepër sekret nga Pekini, shokut Enver, shokut Mehmet, Ministrisë së Jashtme, 24 tetor 1974.

³¹ *AQSH*, F.14/AP-MPKK, V. 1975, D. 6, fl. 70. Mbledhja e datës 14 qershor 1975 në Komitetin Qendror.

³² *AMPJ*, V. 1975, D. 129, fl. 11. Kërkesa për përkrahje dhe përkrahja në organizata të ndryshme të Kinës nga vendi ynë.

³³ *Po aty*, fl. 14. Rivendosja e të drejtës së ligjshme të Konfederatës Pankineze të Kulturës Fizike dhe Sporteve në Olimpiadën Ndërkombëtare.

³⁴ *Po aty*, fl. 17.

në Romë në muajin maj 1975, pas pranimit të Kinës, publikisht delegati kinez falënderoi Shqipërinë për mbështetjen e pakursyer dhe të gjithanshme që kishte bërë ajo për arritjen e këtij rezultati nga ana e vendit të tij.³⁵

Siç shikohet, nga viti 1971 e deri në vitin 1975, Shqipëria e vogël e izoluar nga pjesa tjetër e Evropës, jashtë çdo blloku ushtarak dhe ekonomik, u investua plotësisht për të qenë zëri i Kinës në arenën ndërkombëtare. Investimi politiko-diplomatik shqiptar në OKB, dhe jo vetëm, për rivendosjen e të drejtave të plota të Kinës në këtë organizatë dhe në organizata të tjera ndërkombëtare ishte i madh, krahasuar me peshën dhe specifikën e Shqipërisë në gjysmën e parë të viteve '70 të shek. XX. Fatkeqësisht, investimi i bërë nga Shqipëria në ndihmë të Kinës, nuk u shoqërua edhe me avancime drejt vendeve të tjera. Enver Hoxha duhet ta kuptonte dhe mendojmë se ishte mjaft i ndërgjegjshëm se me pranimin e plotë të Kinës në familjen e kombeve, roli dhe pesha e Shqipërisë në marrëdhëniet me të do të bëheshin të pavlefshme. Një vend gjigant si Kina, nuk mund të rrinte i lidhur vetëm me një shtet aq të vogël si Shqipëria, dhe pa asnjë peshë të rëndësishme në arenën ndërkombëtare. Shqipëria, për mendimin tonë, duhet të kishte ecur paralelisht, edhe marrëdhënien me Kinën ta mbante, por edhe me vendet e tjera të shtonte marrëdhëniet. Në fakt, Enver Hoxha bëri krejtësisht të kundërtën. Ai guxoi deri në limit për të vënë shenjën e barazisë ndërmjet dy vendeve, guxoi të sfidonte lidërshtipin kinez për të mos pritur presidentin amerikan Nikson në Pekin. Sipas Enver Hoxhës, nëse Shqipëria nuk kishte marrëdhënie diplomatike me SHBA-të, atëherë as Kina nuk duhet të kishte. Viti 1975 ishte i fundit përse i përket shkëmbimeve miqësore të

³⁵ *Po aty*, fl. 21. Dëshifrim tepër sekret nga Roma shokut Enver, shokut Mehmet, Ministrisë së Jashtme, 19 maj 1975. “Kryetari i Delegacionit kinez që kishte ardhur këtu lidhur me punimet e asamblesë të komiteteve olimpikë kombëtare, erdhi në ambasadë dhe falënderoi për kontributin e dhënë nga ana jonë lidhur me diskutimin që u bë në asamble për problemin kinez. Tha se po të mos insistonte Shqipëria problemi nuk do të shtrohej. Falënderoi në emër të komitetit olimpik kinez dhe të ambasadorit të tyre këtu. Shtoi se është hera e parë që në një asamble të tillë të diskutohet kaq gjatë problemi i vendosjes së të drejtave të ligjshme të RPK dhe se, sipas tij, u krijua një atmosferë e favorshme për hyrjen e komitetit olimpik kinez në komitetin internacional. Ymeri nga ana e tij e falënderoi për ndihmën që ata i dhanë gjatë punimeve të asamblesë. Pirro”.

mendimeve. Pas letrës së 12 nëntorit 1975* asnjë përgjigje apo ndihmë nuk do t'i vinte më Shqipërisë nga Kina.

Në vitin 1976, Enver Hoxha bën një tjetër përpjekje për të rifituar “dashurinë” e Kinës. Ai më 30 gusht 1976, i dërgon Komitetit Qendror të Kinës një letër/ftesë për të dërguar një delegacion në Kongresin VII të Partisë së Punës të Shqipërisë.³⁶ Përgjigjja nga ana e Komitetit Qendror të Republikës Popullore të Kinës erdhi më 4 tetor 1976 dhe iu bë e ditur Shqipërisë në takimin që sekretari i Komitetit Qendror, Ramiz Alia pati me ambasadorin kinez në Tiranë, Liu Sin Çuan.³⁷ Ambasadori i shprehu keqardhjen që delegacioni kinez nuk mund të vinte në Tiranë për Kongresin VII të PPSH-së pasi kishte një vendim të KQ të Partisë Komuniste të Kinës që në vitin 1969 për të mos marrë pjesë dhe as për të ftuar në kongreset e saj delegacione nga partitë komuniste motra.³⁸ Nga hulumtimi arkivor, më rezultoi se përgjigjja e letrës/ftesë së Enver Hoxhës nga Komiteti Qendror i PKK kishte ardhur me shkrim dore dhe jo e daktilogruar dhe pa firmë, çka donte të thoshte se nuk ishte marrë aspak parasysh.³⁹

Por, Kina nuk u mjaftua me kaq. Në një radiogram sekret të dërguar në Tiranë me urgjencë të madhe nga ambasadori shqiptar në Kinë, Behar

* Shih artikullin tim "Kredia e fundit kineze për Shqipërinë 1974-1975 - prelude i prishjes së marrëdhënieve mes dy vendeve", në *Studime historike*, nr. 1-2, Tiranë: 2018.

³⁶ *AQSH*, F. 14/AP-MPKK, V. 1976, D. 12, fl. 1. “Letër e Komitetit Qendror të PPSH, datë 30 gusht 1976, drejtuar Komitetit Qendror të PKK dhe shënime për takimin e anëtarit të Byrosë Politike të KQ të PPSH, shokut Ramiz Alia, me ambasadorin e RP të Kinës, Liu Sin Çuan, datë 4 tetor 1976, mbi ftuarjen e një delegacioni të Partisë Komuniste të Kinës për të marrë pjesë në punimet e Kongresit VII të PPSH dhe përgjigjen e Komitetit Qendror të PK të Kinës se nuk do të dërgojë delegacionin e saj për të marrë pjesë në këtë kongres”.

³⁷ *Po aty*, fl. 3.

³⁸ *Po aty*, fl. 4. Nga fjala e ambasadorit kinez në takimin me Ramiz Alinë, më 4 tetor 1976: “Siç ju kemi vënë në dijeni më parë, në vitin 1969, para Kongresit të saj të 9-të, Komiteti Qendror i partisë sonë mori një vendim Partia jonë nuk do të ftojë delegacionet e Partive motra për të marrë pjesë në Kongresin e saj, gjithashtu nuk do të dërgojë delegacionin e saj për të marrë pjesë në Kongreset e partive motra. Në bazë të këtij vendimi më vonë partia jonë nuk ka ftuar delegacionet e partive motra për të marrë pjesë në kongreset e saj të 9-të e të 10-të; gjithashtu ajo nuk ka dërguar delegacionin e saj për të marrë pjesë në Kongreset e Partive motra duke përfshirë edhe Kongresin tuaj të 6-të. Tani ky vendim është akoma në fuqi. Prandaj Partia jonë nuk do të dërgojë delegacionin e saj për të marrë pjesë në Kongresin tuaj të 7-të”.

³⁹ Letra gjendet në *Arkivin Qendror të Shtetit*, V. 1976, D. 12, fl. 6-7.

Shtylla, Ramiz Alisë më datë 9 dhjetor 1976, një ditë më parë, Li Hsien Nien i kishte dorëzuar një letër ku akuzonte udhëheqjen shqiptare se kishte sulmuar në Kongresin VII “Teorinë e Tri Botëve”⁴⁰. Interesant është fakti se letra e Komitetit Qendror e Partisë Komuniste të Kinës, nuk kishte as titull, as adresë dhe ngjante më shumë me një promemorie.⁴¹ Në letrën e tij, ambasadori Shtylla, theksonte se i kishte mohuar të gjitha akuzat e parashtruara nga Li Hsien Nieni dhe se Partia e Punës e Shqipërisë dhe udhëheqësi i saj Enver Hoxha asnjëherë nuk e kishin sulmuar Partinë Komuniste të Kinës dhe idetë e kryetarit Mao Ce Dun.⁴² Por, nga ana tjetër, Behar Shtylla kishte cilësuar se PPSH ishte një parti e lirë të shfaqte mendimet e veta duke u nisur nga pozitat e marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletar.⁴³

Letra e KQ të PKK-së ishte tepër e ashpër ndaj Shqipërisë. Në letër, thuhej shprehimisht, se Kina nuk lejonte të tjerët t’i imponoheshin në aplikimin e politikave dhe se “pikëpamjet tuaja [të Shqipërisë] nuk janë të drejta dhe nuk përputhen me parimet e marksizëm-leninizmit, janë në dëm të marrëdhënieve miqësore të partive e të vendeve të Kinës e të Shqipërisë, në dëm të unitetit të lëvizjes komuniste ndërkombëtare”.⁴⁴

Qëndrimi i Enver Hoxhës lidhur me reagimin kinez ndaj Kongresit VII dhe atij vetë [edhe pse në letër nuk iu përmend asnjëherë emri] ishte refraktar. Tashmë ai nuk kishte më asgjë për të humbur. Më 24 dhjetor 1976, dy javë e gjysëm pas mbërritjes së letrës nga ana e KQ të PKK-së, Komiteti Qendror i PPSH i dërgon një letër të gjatë homologëve kinezë ku hedh poshtë të gjitha pikëpamjet që ishin shprehur në letrën e 8

* Për “Teorinë e Tri Botëve” shih artikullin tim “Marrëdhënia e ngushtë Shqipëri-Kinë gjatë Luftës së Ftohtë dhe ‘Teoria e Tri Botëve’”, në *Studime historike*, nr. 3-4, Tiranë: 2017.

⁴⁰ *AQSH*, F.14/AP-MPKK, V. 1976, D. 14, fl. 1. Korrespondencë me ambasadën e RPSH në RP të Kinës për dërgimin e “notës verbale” të udhëheqjes së Partisë Komuniste të Kinës, datë 8 dhjetor 1976, dorëzuar ambasadorit Behar Shtylla nga Li Hsien Nieni për t’ia transmetuar Komitetit Qendror të PPSH, si dhe letër-përgjigjen e Komitetit Qendror të PPSH, datë 24 dhjetor 1976, drejtuar Komitetit Qendror të PK të Kinës, mbi akuzën që bën udhëheqja e PKK se në Kongresin e VII të Partisë së Punës të Shqipërisë u sulmuan publikisht me aluzion vija e Partisë Komuniste të Kinës dhe idetë strategjike të Mao Ce Dunit.

⁴¹ *Po aty*.

⁴² *Po aty*, fl. 2.

⁴³ *Po aty*, fl. 3.

⁴⁴ *Po aty*, fl. 6

dhjetorit.⁴⁵ Kësaj here letra e Komitetit Qendror të PPSH mbante vetëm vulën e institucionit, por jo firmën e Enver Hoxhës. Aty theksohej me shumë forcë se PPSH hidhte poshtë me vendosmëri çdo akuzë që kishte të bënte me sulmin ndaj vijës së Partisë Komuniste të Kinës dhe ideve strategjike të kryetarit Mao Ce Dun.⁴⁶ Në fund të letrës, KQ i PPSH-së kërkonte sqarime konkrete mbi sulmet e supozuara ndaj vijës së PKK-së dhe ideve të kryetarit Mao Ce Dun që të mund të sqaroheshin keqkuptimet dhe të kishte përputhje me tezat parimore për rrugët e arritjes së unitetit.⁴⁷ Ndaj kërkesave të KQ të PPSH-së dhe në përgjithësi ndaj kësaj letre, nuk pati asnjë reagim nga ana e organeve kompetente drejtuese kineze.

Dy studime “të pavarura” të ambasadorit Behar Shtylla për politikën e brendshme dhe të jashtme të Kinës (1976-1977)

Roli dhe pesha e Kinës në fillimin e gjysmës së dytë të viteve '70 po rritej me shpejtësi në marrëdhëniet ndërkombëtare. Eksperimentet e dhimbshme që bëri lidhshipi komunist kinez në vitet '60 dhe triumfi i tyre politik mbi masat e gjera të popullsisë treguan se kur eksperimentet revolucionare merren si të mirëqena, çmimi që duhet paguar për to trajtohet si i paevitueshëm.⁴⁸ Revolucioni Kulturor ishte eksperimenti më i tmerrshëm, por Mao doli më i fortë nga vuajtjet e patreguara të popullit kinez. Mao Ce Duni arriti të bënte përlllogaritjen e saktë se hapja me Shtetet e Bashkuara të Amerikës do t'i jepte fund izolimit të Kinës dhe mbi të gjitha do t'i hapte rrugë njohjes ndërkombëtare të vendit të tij.⁴⁹ Fundi i viteve '60 solli përplasjen kino-sovjetike në brigjet e lumit Usuri.⁵⁰ Në këtë vit, Kina e pa veten papritmas të rrethuar virtualisht nga Bashkimi Sovjetik, shteti prosovjetik i Mongolisë, nga Vietnami i Veriut

⁴⁵ *Po aty*, fl. 32. Letra e plotë dërguar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Kineze në variantin përfundimtar pas korrigjimeve që i bëri Enver Hoxha, fl. 32-39.

⁴⁶ *Po aty*, fl. 39. Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë hedh poshtë me vendosmëri akuzën se "në Kongresin e 7-të, si dhe shumë herë Partia e Punës e Shqipërisë paska sulmuar publikisht me aluzion Partinë Komuniste të Kinës, vijën e saj dhe idetë strategjike të kryetarit Mao Ce Dun".

⁴⁷ *Po aty*.

⁴⁸ H. Kissinger, *World Order; Reflections on the character ...*, f. 223.

⁴⁹ *Po aty*, f. 224.

⁵⁰ Robert D. Kaplan, *The revenge of geography; what the map tells us about coming conflicts and the battle against fate*, New York: Random House, 2012, f. 202.

prosovjetik dhe nga India që ishte prosovjetike. Të gjitha këto “rrethime” çuan në ndarjen e pashmangshme kino-sovjetike, e cila u shfrytëzua mjeshtërisht nga administrata e presidentit Nikson.⁵¹

Pas pranimit në OKB, Kina filloi një proces të shpejtë të transformimeve rrënjësore. Në fund të karrierës së tij politike dhe të jetës, Mao filloi të bënte ndryshimet e fundit. Me një dinakëri të hollë, Mao promovoi çdo fraksion partie dhe më pas i vinte ato kundër njëri-tjetrit.⁵² Dy udhëheqës të mençur të Partisë Komuniste Kineze, Çu En Lai dhe Ten Hsiao Pin e kishin kuptuar lojën e kryetarit Mao dhe domosdoshmëria bëri që të lidhin aleancë. Aleancës Çu-Ten, Mao i vuri përballë grupin që në vija të përgjithshme konsiderohej puritan i vijës së ashpër marksiste-leniniste. Ky grup u etiketua me emrin “Katërshja gangstere” dhe në krye kishte vetë gruan e Maos, Jang Çing.⁵³ Pas vdekjes së Maos, përplasja ndërmjet këtyre dy grupeve do të ashpërsohej së tepërmi dhe mbi të gjithë Kinën dhe botën rrihte si çekan pyetja se cili do të merrte pushtetin. Çu En Lai ishte për të ndërthurur modernen me tradicionalen në politikën kineze dhe shumë shpejt “Katërshja gangstere” filloi të etiketojë kryeministrin si njeriun që donte t’ia shiste atdheun të huajve njëlloj si perandorët kinezë të shek. XIX.⁵⁴

Po diplomacia shqiptare, si i analizoi këto ndryshime të mëdha dhe si u reflektuan ato nga udhëheqja komuniste shqiptare? Më 10 korrik 1976, ambasadori i Republikës Popullore të Shqipërisë në Kinë, Behar Shtylla, dërgon në Tiranë një material tepër sekret, i cili përmbante një studim të tij lidhur me situatën në Kinë pas vdekjes së Çu En Lait.⁵⁵ Studimi i ambasadorit Shtylla flet në vija të përgjithshme për parimet e politikës së jashtme kineze, për qëndrimin ndaj imperializmit, revizionizmit dhe revolucionit në planin ndërkombëtar.⁵⁶ Ambasadori Shtylla përpiqet të shpjegojë brenda të gjithë suazës marksiste-leniniste dhe aq sa ia lejonte

⁵¹ *Po aty*.

⁵² H. Kissinger, *On China ...*, f. 294.

⁵³ *Po aty*, f. 296.

⁵⁴ David Shambaugh, *Deng Xiaoping: portrait of a Chinese statesman*, Oxford: Clarendon press, 2006, f. 14.

⁵⁵ *AQSH*, F. 14/AP-MPKK, V. 1976, D. 8, fl. 1. “Bashkangjitur ju dërgojmë një kopje të një studimi të përgatitur nga shoku Behar Shtylla në Pekin mbi "disa drejtime të politikës së jashtme të Republikës Popullore të Kinës në kohën e sotme". Ministri, Nesti Nase. Dokumenti ka mbërritur në Tiranë me datë 4 gusht 1976 dhe është dërguar po atë ditë nga ministri i Jashtëm në Komitetin Qendror”.

⁵⁶ *Po aty*.

detyra, pa bërë asnjë gabim ideologjik dhe mbi të gjitha pa shkelur vijën e PPSH-së, një analizë të ndryshimeve të mëdha që po ndodhnin në Kinë pas pranimit në OKB. Sipas Behar Shtyllës, Kina në fushën ndërkombëtare kishte arritje të mëdha diplomatike, marrëdhënie me 109 shtete dhe marrëdhënie tregtare me më shumë se 150 vende.⁵⁷ Ajo që të bie më shumë në sy tek analiza e ambasadorit Shtylla, është informacioni zyrtar i përpiktë që ai sjell në Tiranë lidhur me parimet e politikës së jashtme të Kinës ku sipas statutit të PKK-së parimi bazë ishte përmbyjsja e plotë e borgjezisë dhe i të gjitha klasave sunduese.⁵⁸

Gjendjen ndërkombëtare ambasadori Shtylla e përcakton me probleme dhe trazira të mëdha. Sipas tij, Perëndimi nxiste pa pushim revizionizmin sovjetik nga Lindja drejt Kinës. Kjo gjendje rivaliteti sipas ambasadorit shqiptar do të çonte padyshim në luftë botërore.⁵⁹ Kjo analizë e fundit e ambasadorit Shtylla ishte krejtësisht e pasaktë, pasi më 1 gusht 1975 ishte firmosur procesi i Helsinkit⁶⁰ i cili kishte afruar më shumë Perëndimin me Lindjen duke i bërë luftërat gjithnjë e më pak të mundura. Behar Shtylla ndoshta ishte i vetëdijshëm për pamundësinë e luftës, por detyra dhe pozita e tij tepër e rëndësishme në Pekin si përfaqësues i Shqipërisë ia impononte të bënte edhe një analizë aspak koherente. Sipas studimit të tij, ai vinte në dukje shpesh thënien e Çu En Lait se “më përpara duhet të çojmë punët e Kinës dhe t’i japim njerëzimit një kontribut më të madh”.⁶¹ Sipas Shtyllës, analiza dhe qëndrimi zyrtar i Kinës ishte që të mënjanonte ose të paktën të kufizonte në maksimum praninë e Bashkimit Sovjetik në zonat rreth saj.⁶² Por, megjithatë, kryeministri Çu En Lai kishte theksuar se “megjithë divergjencat për çështje parimore midis Kinës dhe Bashkimit Sovjetik nuk duhet të pengojë normalizimi i marrëdhënieve shtetërore mbi bazën e pesë parimeve të bashkekzistencës paqësore”.⁶³

⁵⁷ *Po aty*, fl. 3.

⁵⁸ *Po aty*, fl. 4. "Programi themelor i Partisë Komuniste kineze është që të përmbyset përfundimisht borgjezinë dhe të gjitha klasat e tjera shfrytëzuese, të vendosë diktaturën e proletariatit në vend të diktaturës së borgjezisë, të sigurojë triumfin e socializmit mbi kapitalizmin. Qëllimi i fundit i Partisë është realizimi i komunizmit".

⁵⁹ *Po aty*, fl. 5.

⁶⁰ Henry Kissinger, *Years of renewal*, London: Phoenix Press, 1999, f. 657-658.

⁶¹ *AQSH*, F. 14/AP-MPKK, V. 1976, D. 8, fl. 9.

⁶² *Po aty*, fl. 10.

⁶³ *Po aty*, fl. 11.

Përsa i përkiste Shqipërisë, deri në vitin 1971, Kina sipas Behar Shtyllës, shprehte solidaritet të plotë dhe unitet me PPSH-në të kryesuar nga marksisti i madh, Enver Hoxha.⁶⁴ Pas vitit 1971, Behar Shtylla njoftonte se kjo gjuhë nuk dëgjohej më në Kinë.⁶⁵ Siç e kemi analizuar më lart, pranimi i Kinës në OKB e kishte bërë thuajse të padukshme marrëdhënien e gjigantit aziatik me vendin e vogël ballkanik. “Teoria e tri botëve” ishte një tjetër aspekt që analizon ambasadori Shtylla në studimin e tij, ku shprehej se “kjo teori në praktikë heq nga rendi i ditës luftën revolucionare kundër hegjemonizmit të dy superfuqive”.⁶⁶ Sipas Shtyllës, Kina “hall kishte me Shqipërinë” e cila nuk e përkrahte “Teorinë e tri botëve” dhe që nuk pranonte të futej në botën e tretë “me kallam kusurin”.⁶⁷ Ambasadori Shtylla mendonte se, këto ishin qëndrime pragmatiste që në mjaft raste kishin zbehur vijën e qartë të demarkacionit të Kinës me armikun e klasës në politikën e jashtme.⁶⁸ Kina, sipas ambasadorit Shtylla, përkrahte tezën imperialiste të Evropës së bashkuar që dikur Lenini e kishte luftuar me të drejtë si imperialiste.⁶⁹

Në fund të studimit, ambasadori shqiptar ndalet shkurtimisht tek lufta e dy vijave brenda Partisë Komuniste Kineze ku epërsi për momentin, sipas tij, nga viti 1971 kishte vija e djathtë “e moderuar” e Çu En Lait dhe Ten Hsiao Pinit.⁷⁰ Pas vdekjes së kryeministrit kinez, duket sikur sukcesi i këtij grupimi ishte zbehur, por këtë ai nuk mund ta vërtetonte dot pasi i mungonin faktet.⁷¹ Si për t’i dhënë studimit të tij frymën, të cilën Enver Hoxha dëshironte të ndjente, ambasadori Behar Shtylla shpreh bindjen se ndryshime në politikën e jashtme të Kinës do të ndodhnin, marksizëm-leninizmi do të fitonte mbi oportunizmin dhe për të gjitha këto, barometri më bindës do të ishte qëndrimi i Kinës ndaj Shqipërisë.⁷² Megalomania ishte pjesë e politikës dhe enturazhit të Enver Hoxhës. Behar Shtylla nuk mund të dilte jashtë kësaj logjike, përndryshe

⁶⁴ *Po aty*, fl. 21.

⁶⁵ *Po aty*.

⁶⁶ *Po aty*, fl. 37.

⁶⁷ *Po aty*, fl. 38.

⁶⁸ *Po aty*, fl. 40.

⁶⁹ *Po aty*.

⁷⁰ *Po aty*, fl. 42.

⁷¹ *Po aty*.

⁷² *Po aty*, fl. 43.

mund të etiketohej si “armik i partisë e i popullit” dhe karriera e tij diplomatike, dhe jo vetëm, do të shkatërrohej.

Pas këtij studimi, Behar Shtylla vijon normalisht dërgimin e informacioneve në MPJ lidhur me situatën në Kinë dhe veçanërisht për Ten Hsiao Pinin. Duhet theksuar se informacionet më të shumta që ai dërgonte ishin të marra nga shtypi dhe jo nga ndonjë burim brenda Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Kineze apo nga qeveria e Republikës Popullore të Kinës. Sipas shtypit kinez fushata kundër Tenit do të ishte e gjatë dhe e ndërlikuar dhe do të përqendrohej kundër borgjezisë brenda në PKK.⁷³ Ndërsa, përsa i përket marrëdhënieve me Shqipërinë, qeveria e RPK ishte porositur që të mos nxirrte në shesh vonesat e furnizimeve të objekteve industriale.⁷⁴

Disa muaj më përpara, më 3 prill 1976, ministri i Jashtëm Nesti Nase kishte porositur me anë të një letre sekrete ambasadorin Shtylla që në rast se konstatonte qëndrime nuk përputheshin me qëndrimet e Shqipërisë, nuk duhej të heshte dhe sipas mësimave të partisë t’i thoshte gjërat hapur, ai dhe kolegët në ambasadë.⁷⁵ Por, në asnjë mënyrë nuk duhet të jepte përshtypjen se përgjigjet e shqiptarëve të dukeshin si ndërhyrje në punët e brendshme të Kinës.⁷⁶ Në fund, pasi i çonte të fala e këshillonte që letrën e dërguar ta digjte.⁷⁷

Siç shihet diplomacia shqiptare me kuadrot më të lartë të saj kishin mbetur thjesht refraktarë dhe aspak pragmatistë ndaj ndryshimeve të mëdha që po ndodhnin në Kinë dhe në botë. Kuadrot e lartë kinezë nuk flisnin fare me diplomatët shqiptarë në Pekin.⁷⁸ Izolimi i diplomatit shqiptar në Kinë ishte i plotë dhe këtë e vërteton vetë Behar Shtylla kur i kthen përgjigje ministrit Nesti Nase se kontaktet i kishte shumë të kufizuara dhe se nga nëntori 1975 e deri në qershor 1976, ai nuk kishte lëvizur fare nga Pekini megjithëse kishte kërkuar autorizim, por që i ishte refuzuar.⁷⁹ Gjithashtu, edhe vetë Behar Shtylla kishte katër muaj që nuk

⁷³ AMPJ, V. 1976, D. 186, fl. 69. Informacion sekret mbi gjendjen në Kinë dhe apostafat për Ten Hsiao Pinin. Pekin, 14 korrik 1976.

⁷⁴ Po aty, fl. 71.

⁷⁵ Po aty, f. 239. Letër Behar Shtyllës nga Nesti Nase, Tiranë, 3 prill 1976.

⁷⁶ Po aty.

⁷⁷ Po aty, fl. 240. Pjesë nga letra e ministrit të Jashtëm Nesti Nase, ambasadorit Behar Shtylla në Pekin: "Këtë letër mundësisht pasi ta lexosh, digjeni".

⁷⁸ Po aty, fl. 241.

⁷⁹ Po aty, fl. 242.

kishte bërë asnjë vizitë në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kinës dhe as kishte ftuar njeri në ambasadë.⁸⁰ Për të shtuar kontaktet ai kërkonte disa mundësi minimale edhe pse shkruante se i kuptonte arsyet, përsëri ankohej se kishte mbetur pa informacione të dorës së parë.⁸¹

Politika e vetëizolimit që po praktikonte Enver Hoxha në Shqipëri padyshim që po jepte “frytet” e veta edhe në botë ku ishin akredituar ambasadorët shqiptarë. Çfarë po ndodhte në Shqipëri? Goditjet e herëpashershme të “grupeve armiqësore” nuk kishin sjellë ndryshime për mirë në politikën dhe ekonominë e vendit. Vendi po vijonte të varfërohej dhe që prej vitit 1975, nga Kina nuk do të vinin më ndihma dhe kredi.* Ambasadorët shqiptarë nuk mund t’i jepnin prognoza dhe rekomandime udhëheqjes së lartë politike shqiptare lidhur me përmirësimin e jetës në vend apo më keq akoma t’i ftonin të ndryshonin politikën e brendshme dhe të jashtme. Informacionet që ata sillnin ishin thjesht “*mot á mot*” nga shtypi i vendit ku ishin akredituar apo nga buletinet zyrtarë. Analizë të pavarur ishte e pamundur të bëjë. Megjithatë, për aq sa ia lejonte detyra dhe mbi të gjitha pozita që kishte në Partinë e Punës së Shqipërisë (anëtar i Komitetit Qendror), ambasadori Behar Shtylla dërgon në Tiranë në vitin 1977, një tjetër studim të tij për luftën midis rrymave dhe grupeve të ndryshme në udhëheqjen e Partisë Komuniste të Kinës gjatë periudhës 1976-1977.⁸²

Në studimin e tij, ambasadori Shtylla hedh dyshime se mos ndoshta ka qenë vete Mao Ce Duni ai që ka hedhur kundër njëri-tjetrit dy rrymat brenda partisë.⁸³ Fakte për të mbështetur tezën e tij ai nuk thotë. Gjithashtu, vdekja e Çu En Lait ishte një tjetër përshpejtim i acarimit dhe luftës për pushtet ndërmjet dy rrymave. Grupi i radikalëve apo të

⁸⁰ *Po aty.*

⁸¹ *Po aty.* Pjesë nga letra e ambasadorit Behar Shtylla: “Unë i kuptoj arsyet tuaja, por në rast se kërkoni më tepër, duhen krijuar disa mundësi minimale”.

* Shih artikullin tim “Kredia e fundit kineze për Shqipërinë 1974-1975 ...”.

⁸² *AQSH*, F. 14/AP-MPKK, V. 1977, D. 3, fl. 1. Studim i ambasadorit të RPS të Shqipërisë në RP të Kinës, Behar Shtylla, mbi luftën midis rrymave dhe grupeve të ndryshme në udhëheqjen e PK të Kinës gjatë periudhës 1976-1977 (si janë zhvilluar ngjarjet në Kinë këto 18 muaj; vdekja e Çu En Lait, fushata kundër Ten Siao Pinit e deviacionit të djathtë, vdekja e Mao Ce Dunit dhe lufta midis dy grupeve, grupi i Hua Kuo Fenit mundohet të konsolidojë pushtetin; rrënjët ideologjike dhe historike të ngjarjeve të fundit në Kinë; në ç’drejtim po zhvillohen ngjarjet në Kinë). Pekin, 20 qershor 1977.

⁸³ *Po aty.*

“majtëve” siç i quan ambasadori Shtylla drejtohej nga vetë gruaja e Maos, Çian (Jiang) Çin.⁸⁴ Me vdekjen e Çu-së, vendin e tij si pozitë në shtet e parti e zuri Ten Hsiao Pini, ndërsa Hua Kuo Feni u emërua nga Mao Ce Duni si nënkryetar i parë i Komitetit Qendror të Partisë, post që nuk ekzistonte në Statutin e Partisë.⁸⁵ Hua Kuo Feni ishte njeriu kyç që në shkurt 1976 do të mbante raportin kundër Ten Hsiao Pinit.⁸⁶ Me këtë goditje krahu i moderuar humbi, por sipas ambasadorit Shtylla as krahu radikal nuk fitoi.⁸⁷ Gjithnjë, Mao Ce Duni kishte përdorur këtë taktikë për të vënë përballë grupe dhe rryma të ndryshme brenda partisë, që në fund ta paraqiste veten si shpëtimtarin e situatës.

Akuzat kryesore kundër Ten Hsiao Pinit ishin se kishte vënë në diskutim “vendimet e drejta” të Revolucionit Industrial në të gjitha fushat.⁸⁸ Ndërkohë para se të vdiste Mao Ce Duni kishte lëshuar një direktivë mbi studimin e teorisë së diktaturës së proletariatit, mbi stabilitetin, unitetin dhe zhvillimin e ekonomisë kombëtare.⁸⁹ Për t’ia arritur kësaj duhej marrë si shembull lufta e klasave.⁹⁰ Sipas Behar Shtyllës, Ten Hsiao Pini kishte dashur të vendoste rregull në të gjitha fushat me teoritë e tij revizioniste.⁹¹ Kjo ishte rënia e dytë e Ten Hsiao Pinit që nga koha e spastrimeve të Revolucionit Kulturor. Jo pak herë në Kinë Ten Hsiao Pini ishte konsideruar i pakorrigjueshëm dhe i krahasueshëm me Imre Nagin dhe Nikita Hrushovin.⁹²

Që në tetor 1975, e deri në vendimet e 7 prillit 1976 të Byrosë Politike të PKK, Ten Hsiao Pini konsiderohej si përfaqësues i borgjezisë dhe shkarkimi i tij e emërimi Hua Kuo Fenit, u prit me ovacione.⁹³ Vdekja e Mao Ce Dunit, më 9 shtator 1976, përshejtoi luftën ndërmjet dy rrymave dhe hodhi dyshime se çdo të ndodhte në Kinë pas vdekjes së Maos.⁹⁴ Pasi mori në dorë drejtimin e vendit një muaj pas vdekjes së Maos, më 6 tetor 1976, Hua Kuo Feni arreston katër anëtarë të

⁸⁴ *Po aty*, fl. 2.

⁸⁵ *Po aty*.

⁸⁶ *Po aty*.

⁸⁷ *Po aty*, fl. 3.

⁸⁸ *Po aty*, fl. 4.

⁸⁹ *Po aty*.

⁹⁰ *Po aty*.

⁹¹ *Po aty*, fl. 5.

⁹² *Po aty*.

⁹³ *Po aty*, fl. 6.

⁹⁴ *Po aty*, fl. 7.

rëndësishëm të Byrosë Politike në Kinë, zëvendëskryetarin e KQ të Partisë Van Hun Ven, anëtarin e Komitetit të përhershëm të BP, Çan Çun Çiao dhe anëtarët e Byrosë Politike Çian Çin e Jao Juan.⁹⁵ Në studimin e ambasadorit Shtylla, është shkruar se për të demaskuar kundërshtarët politikë në Byro, akuzat kanë qenë thjesht ideologjike dhe politike pavarësisht nëse ishin të sakta apo jo.⁹⁶ Ambasadori Shtylla hedh dyshime të forta mbi Partinë Komuniste Kineze kur u arrestua grupi i “katërshes gangstere” se si kishte mundësi që këto nuk ishin zbuluar para 30-40 viteve dhe as Hua Kuo Feni që ishte ministër i Sigurimit nuk i kishte zbuluar dhe sa mori pushtetin për tre javë i “sistemoi” të gjithë?⁹⁷ Kur u arrestua gruaja e Maos, asaj iu bënë akuza të forta deri edhe agjente e Guomindangut.⁹⁸ Për Behar Shtyllën, kjo gjë ishte diskreditim për socializmin.⁹⁹

Pas arrestimit të “katërshes gangstere”, Hua Kuo Feni riktheu në poste drejtuese Ten Hsiao Pinin.¹⁰⁰ Për Behar Shtyllën kjo ishte e gabuar dhe idetë revizioniste të Tenit ishin baza e punës drejtuese të Hua Kuo Fenit.¹⁰¹ Vitin 1976, në studimin e tij ambasadori Shtylla e quan mjaft të

⁹⁵ *Po aty*, fl. 7-8.

⁹⁶ *Po aty*, fl. 9.

⁹⁷ *Po aty*.

⁹⁸ H. Kissinger, *On China ...*, f. 329

⁹⁹ *AQSH*, F. 14/AP-MPKK, V. 1977, D. 3, fl. 10. Pjesë nga studimi i ambasadorit Behar Shtylla: “Kurse në fushatën e kritikës kundër "katërshes", së paku në periudhën e parë, veç disa informacioneve verbale, nuk pati argumenta të tilla. Në mungesë të tyre kundërshtarët që morën pushtetin në parti e në shtet filluan të gërmojnë në koshat e plehrave për të prodhuar akuza personale, që të vërtetojnë se këta të katër prej kohësh kanë qenë kundërrevolucionarë, agjentë të Guomindangut të futur kontrabandë në parti, njerëz të degjeneruar, hajdutë, frikamanë, se Ç ian Ç ini, veç të tjerave ka qenë edhe imorale etj. Por çfarë partie qenka kjo që për 30-40 vjet me radhë nuk i paska zbuluar këta? Ç 'bëri vetë Hua Kuo Feni kaq vjet si ministër i sigurimit e nuk i zbuloi dot, kurse pastaj, kur mori fuqinë, në 3 javë e sipër i rregulloi të gjithë "me një grusht të vetëm e pa pikë gjaku", si thuhet në propagandën zyrtare? Po çfarë partie komuniste qenka kjo që për dhjetëra vjet me radhë paska mbajtur në udhëheqje elementë të tillë dhe Mao Ce Duni, ky udhëheqës i madh i padiskutueshëm për 40 vjet me radhë paska mbajtur për grua një putanë dhe agjente të Guomindangut? Këto "argumenta" kthehen kundër vetë Partisë e Mao Ce Dunit, diskreditojnë socializmin”.

¹⁰⁰ H. Kissinger, *On China ...*, f. 330.

¹⁰¹ *AQSH*, F. 14/AP-MPKK, V. 1977, D. 3, fl. 13. Pjesë nga studimi i ambasadorit Behar Shtylla: “Teni quhet viktimë e "katërshes" dhe pasues besnik i Maos. Politikisht ai rehabilitohet, pikëpamjet e tij revizioniste e kundërrevolucionare janë bazë e punës drejtuese të Hua Kuo Fenit, por kthimi i tij në udhëheqës të Partisë e të Shtetit gjen

vështirë për Kinën dhe përsa i përket Shqipërisë, ai njofton se, vendi kishte kaluar në radhën e dytë të vendeve mike më të afërta, e para kishte dalë Koreja e Veriut.¹⁰² Shkak për këtë situatë sipas ambasadorit Shtylla është vetë gjendja e brendshme në Partinë Komuniste të Kinës, pasi, sipas tij, dukej se vija e saj nuk ishte e vendosur mirë në binarë të shëndoshë të marksizëm-leninizmit.¹⁰³ Për ambasadorin Shtylla qysh në fillim të ekzistencës së saj Partia Komuniste Kineze nuk ishte zhvilluar në bazën e mësimëve të Leninit dhe të Stalinit.¹⁰⁴ Por, ajo që nuk shihte ambasadori Shtylla, apo nuk dëshironte të theksonte ishte fakt që Kina kishte hyrë në një rrugë pa kthim të transformimeve të mëdha ekonomike, kulturore, tregtare dhe diplomatike si pjesë e programit të hapjes së saj ndaj botës. Studimet përkatëse të ambasadorit Shtylla lidhur me situatën në Kinë në vitet 1976 dhe 1977 janë thjesht ideologjike të mbështetura në shumicë mbi të dhënat në shtypin e kohës në Kinë dhe aspak në realitete mbi atë se çfarë në të vërtetë po ndodhte atje. Kina pas vdekjes së Çu En Lait dhe Mao Ce Dunit po hynte me shpejtësi në një epokë të re të zhvillimit të saj. Studimi me themel i teorisë marksiste-leniniste dhe edukimi komunist i masave nuk përbënin më kalitjen e ndërgjegjes së klasës punëtore. Sipas Behar Shtyllës, zërthimi i teorisë marksiste bëhej me fushatë, mbledhje masive e me përsëritje sloganesh.¹⁰⁵ Sipas kësaj mënyre, ambasadori shtronte pyetjen, sesi mund të luftohej me sukses revizionizmi në Kinë?¹⁰⁶

Një tjetër shqetësim i parashtruar nga ambasadori Shtylla është edhe fakti se në Kinë çdo pesë vjet ishte goditur nga një grup antiparti.¹⁰⁷ Po

rezistencë në parti e në popull. Duket edhe Hua Kuo Feni vetë ia ka frikën. Tani po rritet presioni për rikthimin e tij në udhëheqje”.

¹⁰² *Po aty*.

¹⁰³ *Po aty*, fl. 14.

¹⁰⁴ *Po aty*, fl. 15.

¹⁰⁵ *Po aty*, fl. 16. Pjesë nga studimi i ambasadorit Behar Shtylla: “Formalizimi në studimin e teorisë m-l dhe në edukimin komunist të njerëzve ka penguar formimin teorik dhe kalitjen e ndërgjegjes komuniste në anëtarët e Partisë, në klasën punëtore dhe në masat. Studimi i teorisë këtu bëhet me fushatë, me mbledhje masive e duke përsëritur slogane që njeri nuk i zëbërthen dhe secili i përsërit pa lëvizur asnjë presje, pa bërë përpjekje efektive për t'i lidhur me realitetin dhe luftën konkrete”.

¹⁰⁶ *Po aty*, fl. 17.

¹⁰⁷ *Po aty*, fl. 19. Sipas studimit të ambasadorit Behar Shtylla, “më 1954 grupi i Gao Ganit, më 1959 Pin De Huai, më 1965-1966 grupi i Liu Shao Çisë. Të gjithë këta kanë qenë të djathtë. Revolucioni Kultural, në bazë të materialeve të botuara, u shpërthye [u nxit] nga Mao Ce Duni për të kapërcyer krizën e thellë që kish pllakosur PK të Kinës,

ashtu, sipas tij, edhe vetë Revolucioni Kulturor nuk u çua deri në fund nga Mao Ce Duni, pasi ose ishte trembur nga pasojat e thella të tij, ose nga paaftësia, ose sepse ia doli të eliminonte Liu Shao Çinë.¹⁰⁸ Në fund të studimit të tij, ambasadori Shtylla jep disa detaje lidhur me marrëdhëniet e Shqipërisë me Kinën. Sipas tij, pas Kongresit VII të PPSH marrëdhëniet e Partisë Komuniste Kineze me PPSH sa vinin e ftoheshin.¹⁰⁹ Për mendimin e ambasadorit Shtylla ngjarjet që po zhvilloheshin në Kinë ishin një tragjedi për popullin kinez që kishte sakrifikuar aq shumë për të ndërtuar socializmin si dhe dëmtonin lëvizjen marksiste-leniniste në botë.¹¹⁰ Në fakt, tragjedinë e vërtetë në kuptimin e plotë të fjalës do ta vuante populli shqiptar nën dhjetëvjeçarën e fundit të sundimit diktatorial komunist. Vetëizolimi ku Enver Hoxha e çoi Shqipërinë, do të sillte pasoja mjaft të rënda dhe jashtë çdo lloj parashikimi për ekonominë, politikën dhe kulturën shqiptare. Pasojat e kësaj politike të mbrapshtë, do t'i vuante i gjithë populli shqiptar. Nëse Kina fillon dhe hyn në një epokë prosperiteti të pakufishëm që do ta karakterizojë deri në ditët tona, Shqipëria nga epoka e vetëizolimit, ende nuk po e gjen dot rrugën e saj jashtë tranzicionit të gjithanshëm.

Përfundime

Marrëdhëniet shqiptaro-kineze në vitet '70 patën lëkundjet e tyre. Diplomatët shqiptarë, veçanërisht ata që shërbenin në Republikën Popullore të Kinës patën jo pak vështirësi në përmbushjen e misioneve të tyre për shkak të acarimeve politike që ndodhën ndërmjet dy udhëheqjeve ku padyshim fajtoje ishte ajo shqiptare. Duke qenë se vend tjetër komunist radikal ku të mbështetej nëse prishej me Kinën nuk kishte, Shqipërisë i duhej me domosdo ta mbante fort lidhjen me fuqinë e madhe

për të shpartalluar vijën revizioniste të Liu Shao Çisë-Ten Siao Pinit dhe shpëtuar revolucionin”.

¹⁰⁸ *Po aty*, fl. 20.

¹⁰⁹ *Po aty*, fl. 33. Pjesë nga studimi i ambasadorit Behar Shtylla: “Marrëdhëniet e Partisë Komuniste të Kinës me Partinë e Punës së Shqipërisë dhe të Republikës Popullore të Kinës me Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë sa vijnë e po ftohen për shkak të qëndrimit të udhëheqjes së re kineze, sidomos pas Kongresit të 7 të Partisë tonë ku edhe një herë shoku Enver dhe gjithë Partia ripohuan besnikërinë dhe qëndrimin tonë të patundur në vijën e drejtë heroike marksiste-leniniste, në parimet bazë fitimtare të marksizëm-leninizmit dhe kur Partia e Punës e Shqipërisë është bërë flamuri i paepur i lëvizjes marksiste-leniniste dhe i revolucionit të vërtetë socialist në botë”.

¹¹⁰ *Po aty*.

aziatike dhe botërore. Enver Hoxha priste personalisht të gjitha delegacionet e mundshme kineze të nivelit të dytë e të tretë kur vinin në Shqipëri, denonconte shtypin revizionist kur deklaronte se ishte ftohur marrëdhënia shqiptaro-kineze. Në një raport të gazetarit dhe diplomatit shqiptar, Hajdar Muneka dërguar Tiranës më 20 janar 1977, kinezët prisnin që sulmin e parë ta bënin shqiptarët, ndërsa sulm të hapur nga ana e kinezëve nuk do të kishte.¹¹¹

Si për të bërë një përpjekje të fundit për të ruajtur miqësinë me Kinën nga e cila varej mbijetesa ekonomike e Shqipërisë, Ramiz Alia më datë 5 dhjetor 1977 lëshon udhëzimin për diplomatët në MPJ të Shqipërisë ku nxit zhvillimin shtetëror të marrëdhënieve me Kinën sipas udhëzimeve të Kongresit VII.¹¹² Marrëdhëniet me Kinën, udhëzonte Ramiz Alia, duhet patjetër të mbaheshin dhe të mos nxitej më shumë keqësimi i tyre.¹¹³ Por, e keqja ishte bërë. Lidërshipi komunist shqiptar nën drejtimin e Enver Hoxhës me anë të politikave krejtësisht të pakujdesshme dhe delirante kishte çuar në këtë situatë të rëndë. Shqipëria po mbetej vetëm (siç edhe ndodhi). Vetëzolimimi ishte i vetmi opsion për Enver Hoxhën që të vijonte të ruante pushtetin e tij të dhunshëm diktatorial. Prishja me Kinën do të ndodhë shtatë muaj më vonë në korrik të vitit 1978.* Populli shqiptar do të detyrohej të jetonte si në rrethim edhe për 12 vjet të tjerë sa të kishte jetë sistemi komunist. Diplomacia shqiptare e kishte të pamundur të ndikonte në vendimmarrjen e lidërshiptit të Enver Hoxhës. Shqipëria po shkonte drejt fatit të saj tragjik të problemeve të panumërta. Komunizmi shqiptar po i bënte “dhuratat” e fundit vendit: vetëzolimimin dhe ndërtimin e socializmit me forcat e veta.

S u m m a r y

THE ALBANIAN-CHINESE DIVERGENCES IN THE INFORMATIONS OF THE ALBANIAN DIPLOMATS (1971-1977)

The Albanian diplomacy during the '70ies of the Cold War, concerning the relations with the People's Republic of China, was very careful to transmit mot

¹¹¹ AMPJ, V. 1977, D. 241, fl. 3.

¹¹² *Po aty*, fl. 103.

¹¹³ *Po aty*.

* Shih artikullin tim “Kreditë dhe ndihmat kineze në Shqipëri 1956-1978 ...”.

á mot every single word to the Albanian leadership. Except two "independent studies" based on press information about what was happening in China just before and after the death of Mao Zedong, the Albanian ambassadors wouldn't dare to instruct Enver Hoxha how to deal with China. Foreign policy was totally at the hand of the Albanian dictator and the Albanian ambassadors were only couriers of the Party of Labour of Albania. The Albanian ambassadors were totally aware of the terrible consequences that would fall on them if they would challenge this unwritten rule. To everybody was imposed the self-isolation doctrine and the building of socialism with our own forces by Enver Hoxha. This situation remained unchanged until the end of the communist regime in Albania.

